FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 37	2002	Korrik

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr. 282, datë 27.6.2002	Për kalimin e një pjese të territorit të INIMA-s dhe të INSTAT-it në administrim të Kryeministrisë……	1119
Vendim i KM nr. 283, datë 27.6.2002	Për përcaktimin e shtrirjes dhe të numrit të përgjithshëm të zyrave vendore të Avokaturës së Shtetit…….	1121
Vendim i KM nr. 285, datë 27.6.2002	Për tarifat e shërbimeve që kryen Policia e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit ndaj shtetasve dhe personave, juridikë e fizikë, vendas e të huaj……	1121
Vendim i KM nr.288, datë 27.6.2002	Për përcaktimin dhe marrjen e masave kundër zjarrit dhe shpëtimin në objektet me rëndësi ekonomike dhe shtetërore…… …….	1123
Vendim i KM nr. 289, datë 27.6.2002	Për riorganizimin e Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit në objektet me rëndësi ekonomike…….	1125
Vendim i KM nr. 290, datë 27.6.2002	Për një ndryshim në vendimin nr.319, datë 23.6.2000 të Këshillit të Ministrave "Për shfuqizimin e vendimit nr.433,	

	datë 3.9.1993 të Këshillit të Ministrave "Për ndalimin e importimit të gomave të përdorura "……..	1128
Vendim i KM nr.295, datë 27.6.2002	Për shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme, të cilat preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Korçë-Kapshticë në territorin e qarkut Korçë……..	1129
Vendim i KM nr.296, datë 27.6.2002	Për shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme, të cilat preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Shkodër-Velipojë…….	1135
Vendim i KM nr.301, datë 27.6.2002	Për një ndryshim në vendimin nr.277, datë 18.7.1997 të Këshillit të Ministrave "Për përfitimet nga statusi i të verbërit"…… ……..	1136
Vendim i KM nr. 302, datë 27.6.2002	Për një ndryshim në vendimin nr.31, datë 20.1.2001 të Këshillit të Ministrave "Për përfitimet nga statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik"…….	1136
Vendim i KM nr. 303, datë 27.6.2002	Për miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave të punonjësve të Drejtorisë së Patentave dhe Markave…….	1137
Vendim i KM nr. 304, datë 27.6.2002	Për disa ndryshime në vendimin nr.311, datë 11.7.1994 të Këshillit të Ministrave "Për përfitimin e paaftësisë" me ndryshimet përkatëse……	1138
Vendim i KM nr. 315, datë 4.7.2002	Për një trajtim të veçantë të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura pas lirimit nga detyra…… ……	1139
Vendim i KM nr. 316, datë 4.7.2002	Për mënyrën e trajtimit me strehim të jetimëve…….	1140
Vendim i KM nr. 317, datë 4.7.2002	Për likuidimin e shoqërisë anonime "Agjencia për Zhvillim Ekonomik" (AZHE)……	1141
Vendim i KM nr. 318, datë 4.7.2002	Për vendosjen e oficerëve të kontaktit të Ministrisë së Rendit Publik pranë ministrive homologe të Greqisë, Italisë, Turqisë dhe UNMIK-ut Kosovë, të atashuar në përfaqësitë diplomatike të Republikës së Shqipërisë…….	1141
Vendim i KM nr. 323, datë 4.7.2002	Për kalimin e korpusit trekatësh të "Alimpeks" sh.a.-së Shkozet, Durrës, në pronësi të Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale…….	1142

Vendim i KM nr. 324, datë 4.7.2002	Për pagesën e kontributeve të Organizatës Ndërkombëtare të Migracionit (IOM)……	1143

V E N D I M
Nr. 282, datë 27.6.2002

PËR KALIMIN E NJË PJESE TË TERRITORIT TË INIMA-S DHE TË INSTAT-IT NË ADMINISTRIM TË KRYEMINISTRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 14 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Kryeministrisë t'i jepet në administrim territori i shënuar i planimetrisë dhe gentplanin, që i bashkëlidhen këtij vendimi.
2. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave dhe drejtuesit e INIMA-s dhe të INSTAT-it për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko





V E N D I M
Nr. 283, datë 27.6.2002

PËR PËRCAKTIMIN E SHTRIRJES DHE TË NUMRIT TË PËRGJITHSHËM TË ZYRAVE VENDORE TË AVOKATURËS SË SHTETIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 7 të ligjit nr. 8551, datë 18.11.1999 "Për Avokaturën e Shtetit", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Zyrat vendore të Avokaturës së Shtetit vendosen pranë gjykatave të apelit të Tiranës, Durrësit, Shkodrës, Vlorës, Gjirokastrës dhe Korçës.

2. Prefektët e qarqeve: Tiranë, Durrës, Shkodër, Vlorë, Gjirokastër, Korçë t'u japin në përdorim, pa shpërblim, mjediset e nevojshme brenda prefekturës, avokatëve të zyrës vendore, përkatëse, të Avokaturës së Shtetit.

3. Ngarkohen Avokatura e Përgjithshme e Shtetit dhe prefektët e qarqeve të lartpërmendura për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M
Nr. 285, datë 27.6.2002

PËR TARIFAT E SHËRBIMEVE QË KRYEN POLICIA E MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIT NDAJ SHTETASVE DHE PERSONAVE, JURIDIKË E FIZIKË, VENDAS E TË HUAJ

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 2/b dhe 3 të nenit 17, e pikës 2 të nenit 20 të ligjit nr. 8766, datë 5.4.2001 "Për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin", me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Tarifat e shërbimeve, që kryen Policia e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit, ndaj shtetasve dhe personave, juridikë e fizikë, vendas e të huaj, janë si më poshtë vijon:

1. Për kundërfirmimin e studimeve urbanistike, të planeve rregulluese, projekteve të shesheve të të ndërtimit dhe të objekteve brenda tyre, sipas përcaktimit të nenit 30 të ligjit nr. 8766, datë 5.4.2001 "Për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin", tarifat përcaktohen:

1.1. Për projektet e mbrojtjes nga zjarri, që u bëhen studimeve urbanistike dhe planeve rregulluese, tarifa të jetë 0.5 për qind e vlerës së projektit.

1.2. Për banesat, rikonstruksionet e tyre e shtesë kati në to, si dhe për çdo lloj objekti ndërtimi, me vlerë deri në 1 000 000 lekë, tarifa të jetë 500 (pesëqind) lekë.

1.3. Për banesat, dyqanet, lokalet, serviset, repartet artizanale, magazina mallrash etj., me vlerë investimi nga 1 000 000 deri në 2 000 000 lekë, tarifa të jetë 1 000 (një mijë) lekë.

1.4. Për hotelet, motelet, rezidencat, komplekse dyqanesh ose supermarkete me vlerë investimi deri në 20 000 000 lekë, tarifa të jetë 5 000 (pesë mijë) lekë.

1.5. Për objektet me vlerë investimi deri në 50 000 000 lekë, tarifa të jetë 10 000 (dhjetë mijë) lekë.

1.6. Për objektet me vlerë investimi mbi 50 000 000 lekë, tarifa të jetë 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë.

1.7. Për ndërtime qyteza e fshatra turistike, si dhe për vepra të tjera me vlerë investimi mbi 1

000 000 USD, tarifa të jetë 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë.

2. Për objektet me rrezik të theksuar për rënie zjarri e shpërthimi

2.1. Për fabrikat, uzinat e qendrat e përpunimit të naftës e gazit të lëngëzuar, fabrikat e polisterolit e për prodhime kimikatesh, si dhe për vepra e objekte me proces teknologjik me rrezik zjarri të kategorive "A" dhe "B" (përcaktuar me rregulloren e projektimit të ndërtesave të çdo lloji), tarifa të jetë 30 000 (tridhjetë mijë) lekë.

2.2. Për depo qëndrore karburanti, pika të shitjes së karburanteve dhe impianti të depozitimit dhe mbushjes të bombulave me gaz të lëngëzuar, tarifa të jetë 20 000 (njëzet mijë) lekë.

2.3. Për qendra e magazina të depozitimit të gazit të lëngshëm me shumicë, të karburanteve e lubrifikantëve në fuçi, të kimikateve e lëndëve të tjera me rrezik zjarri, tarifa të jetë 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë.

2.4. Për projekte të shfrytëzimit të burimeve të naftës, puse të shpim-kërkimit për tubacionet magjistrale të transportimit dhe për të gjithë infrastrukturën që lidhet me shfrytëzimin e tyre, tarifa të jetë 20 000 (njëzet mijë) lekë.

2.5. Për fabrika mielli, përpunimi druri, përpunimi të bimëve medicinale, të prodhimit të veshjeve dhe objekteve të tjera me proces teknologjik me rrezik zjarri të kategorisë "C", tarifa të jetë 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë.

2.6. Për fabrika e ndërmarrje të përpunimit e prodhimit të produkteve ushqimore, të detergjentëve, të prodhimit kozmetik, të pijeve alkoolike etj. tarifa të jetë 20 000 (njëzet mijë) lekë.

2.7. Për rikonstruksionet që kryen në të gjitha këto objekte, të cilat bëhen në bazë të projekteve përkatëse, tarifa të jetë 5 000 (pesë mijë) lekë.

3. Për kontrollin teknik pas përfundimit të punimeve

3.1. Policia e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit, në përfundimin e veprës apo të objektit, kontrollon, harton dhe u jep personave, juridikë e fizikë, shoqërive, private e shtetërore, aktin teknik përkatës, në mbështetje të nenit 31 të ligjit nr. 8766, datë 5.4.2001, tarifa e të cilit të jetë 5 000 (pesë mijë) lekë.

3.2. Për përdorimin e automjeteve (autobote) që transportojnë karburante, gaze të lëngëzuar, alkoole, kimikate me rrezik zjarri, jepet akti teknik për plotësimin e normave teknike të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit, tarifa e të cilit të jetë 1 000 (një mijë) lekë.

3.3. Për ripërtëritjen vjetore të aktit teknik, tarifa të jetë 1 000 (një mijë) lekë.

4. Drejtoria e PMNZSH-së u jep personave juridikë, vendas e të huaj, licencën për prodhimin, mirëmbajtjen dhe tregtimin e teknikës, pajisjeve zjarrfikëse dhe lëndëve për shuarjen e zjarrit, tarifa e së cilës të jetë 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë. Ripërtëritja e licencës bëhet çdo vit, kundrejt tarifës prej 10 000 (dhjetë mijë) lekësh.

5. Për kryerjen e aktekspertizës për zjarret e rëna, kur kërkohet nga organet e prokurorisë, të gjykatës ose nga vetë shtetasit, personat, juridikë e fizikë, vendas e të huaj, tarifa të jetë 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë.

6. Të gjitha shumat e arkëtuara të derdhen në degët e thesarit për llogari të buxhetit përkatës të prefekturës, nga të cilat 30 për qind i kalojnë Buxhetit të Shtetit dhe 70 për qind përdoren për nevojat e Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit.

7. Të ardhurat që i kalojnë shërbimit të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit të përdoren për mbulimin e shpenzimeve të kryera për realizimin e të ardhurave dhe për financimin e veprimtarive kryesore për shpenzimet operative, rinovimin e automjeteve dhe pajisjeve zjarrfikëse, për investime dhe për shpërblimin e punonjësve.

8. Vendimi nr. 556, datë 10.10.1994 i Këshillit të Ministrave "Për tarifat e shërbimeve që u kryhen personave, juridikë dhe fizikë, nga inspektorati zjarrfikës" shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M
Nr. 288, datë 27.6.2002

PËR PËRCAKTIMIN DHE MARRJEN E MASAVE KUNDËR ZJARRIT DHE SHPËTIMIN

NË OBJEKTET ME RËNDËSI EKONOMIKE DHE SHTETËRORE

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 100 të Kushtetutës, të pikave 1 e 6 të nenit 4, të neneve 6 dhe 41 të ligjit nr.8766, datë 5.4.2001 "Për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin", me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Përcaktimin si vepra me rëndësi ekonomike në shkallë vendi, të objekteve, sipas listës në lidhjen nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Vendosjen dhe krijimin e stacioneve të mbrojtjes kundër zjarrit dhe shpëtimit, të gatishmërisë së përhershme, në këto objekte të cilat të jenë në përbërje e limit organik të institucioneve, që i administrojnë ose i kanë në pronësi.

3. Shpenzimet financiare për ngritjen dhe funksionimin e këtyre stacioneve zjarrfikëse, ku përfshihen shpenzimet për investime, shpenzimet administrative, fondi i pagave, pajisja materialo-teknike, sipas normave teknike, blerja e automjeteve zjarrfikëse, të përballohen nga të ardhurat që realizojnë subjektet, të cilat kanë në pronësi këto objekte.

4. Institucionet me rëndësi shtetërore, sipas listës në lidhjen nr.2, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi, të plotësojnë objektet e tyre me teknikë e pajisje, me sisteme sinjalizimi, sisteme stacionare të parandalimit, mbrojtjes dhe shuarjes së zjarrit, me hidrante zjarrfikëse dhe me mjete e pajisje të tjera shpëtimi, brenda tremujorit të tretë të vitit 2002.

5. Në këto institucione të vendoset inspektor profilaksie, i cili të jetë përgjegjës për të gjitha masat profilaktike kundër zjarrit, për njohjen dhe përdorimin e pajisjeve zjarrfikëse dhe të mbajë në gatishmëri të gjithë teknikën dhe pajisjet zjarrfikëse që gjenden në objekt.

6. Subjektet që kanë në administrim objektet sipas lidhjes nr.3, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi, të marrin masa parandaluese dhe ndërhyrëse kundër zjarrit, duke i pajisur ato me teknikë e pajisje, me sisteme sinjalizimi, sisteme stacionare të parandalimit, mbrojtjes dhe shuarjes së zjarrit, me hidrante zjarrfikëse dhe me mjetet e pajisjet e tjera të shpëtimit.

7. Drejtimi metodik dhe kualifikimi profesional i personelit të stacioneve zjarrfikëse të objekteve me rëndësi ekonomike, të kryhet nga Drejtoria e Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit dhe shefat e qarqeve ku ato janë të vendosur.

8. Trajnimi dhe certifikimi i inspektorëve të profilaksisë në objektet me rëndësi shtetërore të kryhet nga shefat e Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit dhe prefektët e qarqeve, sipas një programi të miratuar nga drejtoria e lartpërmendur.

9. Ngarkohen Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, prefektët, ministritë dhe institucionet e tjera qendrore, subjektet me rëndësi shtetërore dhe ekonomike, private apo shtetërore, sipas përcaktimeve të këtij vendimi, të marrin masat e nevojshme për zbatimin dhe ngritjen e strukturave të PMNZSH-së.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

LIDHJA NR.1
LISTA E OBJEKTEVE ME RËNDËSI EKONOMIKE

1. Porti detar, Vlorë
2. Porti detar, Durrës
3. Porti detar, Shëngjin
4. Porti detar, Sarandë
5. Aeroporti Ndërkombëtar, Rinas
6. KPTHN, Ballsh
7. Uzina e Plehrave Azotike, Fier
8. TEC-Rrafineri, Fier

9. Rezervat e Shtetit, ku ndodhen mbi 4 (katër) depo masive
10. Depot e ruajtjes dhe të shpërndarjes së naftës dhe nënprodukteve të saj me shumicë mbi 3000 m^3
11. Stacionet e ruajtjes dhe mbushjes së gazit të lëngshëm me mbi 200 m^3 gaz të lëngshëm
12. Hidrocentrali i Komanit
13. Hidrocentrali i Fierzës
14. Hidrocentrali i Banjës
15. Hidrocentrali i Vaut të Dejës
16. Hidrocentrali "Bistrica 2"
18. Hidrocentrali i Ulzës
19. Hidrocentrali i Shkopetit
20. Hidrocentrali i Lanabregasit, Tiranë
21. Hidrocentrali i Bogovës, Berat
22. Hidrocentrali i Gjançit, Korçë
23. Superstrada
24. Parku Kombëtar i Tiranës
25. Paraqet Kombëtare, me masive pyjore, si Dajti, Lura, Llogaraja, Divjaka etj.

LIDHJA NR.2
LISTA E OBJEKTEVE ME RËNDËSI SHTETËRORE

1. Godina e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë
2. Godina e Presidencës
3. Godina e Kryeministrisë
4. Godinat e ministrive
5. Godinat e gjykatave të të gjitha niveleve
6. Godinat e prokurorive të të gjitha niveleve
7. Godina e SHIK-ut
8. Godina e Radio-Televizionit Shqiptar
9. Godina e Bankës së Shqipërisë dhe degët e saj
10. Godina e Arkivit Qendror
11. Godina e ATSH-së
12. Godina e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme
13. Godina e Pallatit të Kongresve
14. Teatri Kombëtar
15. Godina e Teatrit të Operas dhe Baletit
16. Godina e Bibliotekës Kombëtare dhe degët e saj
17. Godina e Muzeut Historik Kombëtar
18. Godina e Bankës së Kursimeve dhe degët e saj
19. Godinat e bankave të tjera, të huaja, që zhvillojnë veprimtari në vendin tonë
20. Godina e Arkivit të Filmit
21. Qytetet dhe lagjet muze
22. Spitalet
23. Fabrikat e miellit
24. Fabrikat e prodhimeve të kimikateve
25. Të gjitha objektet që kanë në shfrytëzim persona juridikë për prodhime dhe magazinime

LIDHJA NR.3
OBJEKTET SOCIAL-KULTURORE DHE OBJEKTE ME RËNDËSI EKONOMIKE

1. Kinematë dhe objektet kulturore masive
2. Hotelet
3. Magazinat e të gjitha kategorive
4. Pikat e shitjes me pakicë të karburanteve
5. Pikat e shitjes me pakicë të gazit të lëngshëm

6. Magazinat e të gjitha kategorive
7. Fabrikat dhe linjat e prodhimit të të gjitha kategorive

V E N D I M
Nr. 289, datë 27.6.2002

PËR RIORGANIZIMIN E POLICISË SË MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIT NË OBJEKTET ME RËNDËSI EKONOMIKE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikave 1, 2, 5 e 6 të nenit 4 dhe të nenit 41 të ligjit nr. 8766, datë 5.4.2001 "Për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin", me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në objektet me rëndësi ekonomike: Aeroportin Ndërkombëtar "Nënë Tereza" sh.a., Portin Detar Durrës sh.a., Kombinatin e Përpunimit të Thellë të Naftës (KPTHN) "Armo" Ballsh sh.a. të struktorohen stacionet e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit.

Limiti organik, teknika e pajisjet e tyre të jenë jo më të vogla se përcaktimet e lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Limitet organike të stacioneve të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit të këtyre objekteve, të cilat janë strukturë e Drejtorisë së Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit, në Ministrinë e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, të kalojnë limit organik, përkatësisht, të Albtransport Rinas Tiranë sh.a. dhe të Portit Detar Durrës sh.a., në varësi të Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit, të KPTHN "Armo" Ballsh sh.a., në varësi të Ministrisë së Industrisë dhe Energjetikës.

3. Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, prefektët e qarqeve Tiranë, Durrës e Fier, të bëjnë kalimin kapital të mjeteve themelore, si teknikën e pajisjet, inventarin e stacioneve të PMNZSH-së, të vendosura për funksionimin e këtyre objekteve.

4. Shpenzimet financiare për funksionimin e stacioneve të MNZSH-së në Aeroportin Ndërkombëtar "Nënë Tereza" sh.a., Portin Detar Durrës sh.a., dhe KPTHN, "Armo", Ballsh sh.a., ku përfshihen shpenzimet për investime, shpenzimet administrative, fondi i pagave, sigurimet shoqërore e shëndetësore, pajisja materialo-teknike e stacioneve sipas normave teknike, të përballohen nga të ardhurat që realizojnë këto subjekte, pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

5. Drejtoritë e ndërmarrjeve Albtransport Rinas, Tiranë sh.a., Porti Detar Durrës, sh.a., KPTHN "Armo", Ballsh, sh.a., të plainifikojë fondet për investime në infrastrukturën e këtyre stacioneve dhe për pajisjen me teknikë, në përputhje me normat teknike dhe ato ndërkombëtare të pranuara.

6. Emërtimi, titullimi, transferimi dhe lirimi nga detyra e oficerit në organikë të stacionit të PMNZSH-së në këto objekte bëhen nga Ministri i Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit.

7. Pajisja me personel shërbimi e këtyre stacioneve të bëhet nga prefekti i qarkut, me propozimin e drejtorive përkatëse të këtyre objekteve dhe shefit të stacionit të PMNZSH-së së objektit, duke zbatuar kriteret e përcaktuara në ligjin nr. 8766, datë 5.4.2001 dhe aktet e tjera nënligjore në zbatim të tij.

8. Organizimi, drejtimi dhe formimi prefesional i personelit të këtyre stacioneve të bëhen nga shefi i PMNZSH-së së objektit dhe të kontrollohen nga Drejtoria e PMNZSH-së.

9. Ngarkohen Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, Ministria e Industrisë dhe Energjetikës dhe Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit të nxjerrin urdhrat administrative të nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

10. Prefekti i qarkut të sigurojë funksionimin e stacioneve të PMNZSH-së në këto objekte, deri në përfundimin e procedurave të kalimit dhe riorganizimit.

11. Detyrat e përcaktuara në këtë vendim të përfundojnë brenda tremujorit të tretë të vitit 2002.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

LIDHJA 1

STACIONI I PMNZSH-SË TË AEROPORTIT NDËRKOMBËTAR TË RINASIT

Personeli:

1. Shefi i PMNZSh-së së objektit	Oficer	1 (një)
2. Komandant stacioni	n/oficer	1 (një)
3. Komandant turni	Polic	4 (katër)
4. Shoferë zjarrfikës	Polic	12 (dymbëdhjetë)
5. Policë zjarrfikës	Polic	16 (gjashtëmbëdhjetë)
Totali	Oficer	1 (një)
	Policë	33 (tridhjetë e tre)

Teknika zjarrfikëse:

1. Autozjarrfikëse	2 (dy)
2. Autozjarrfikëse shpëtimi	1 (një)
3. Autozjarrfikëse e ndihmës së shpejtë	1 (një)
4. Motopompa portative	2 (dy)
5. Radio ndërlidhjeje	5 (pesë)

LIDHJA 1
STACIONI I PMNZSH-SË TË PORTIT DETAR DURRËS

Personeli:

1. Shefi i PMNZSH-së së objektit	Oficer	1 (një)
2. Komandant stacioni	Polic	1 (një)
3. Komandant turni	Polic	4 (katër)
4. Shoferë zjarrfikës	Polic	12 (dymbëdhjetë)
5. Policë zjarrfikës	Polic	16 (gjashtëmbëdhjetë)
Totali	Oficer	1 (një)
	Policë	33 (tridhjetë e tre)

Teknika zjarrfikëse:

1. Autozjarrfikëse	3 (tre)
2. Autozjarrfikëse shpëtimi	1 (një)
3. Autozjarrfikëse e ndihmës së shpejtë	1 (një)
4. Motopompa portative	2 (dy)
5. Radio ndërlidhjeje	5 (pesë)

LIDHJA NR. 1
STACIONI I PMNZSH-SË I KOMBINATIT TË PËRPUNIMIT TË THELLË TË NAFTËS BALLSH

Personeli:

1. Shefi i PMNZSh-së së objektit	Oficer 1 (një)
2. Komandant stacioni	Polic 1 (një)
3. Komandante turni	Polic 4 (katër)
4. Shoferë zjarrfikës	Polic 12 (Dymbëdhjetë)
5. Policë zjarrfikës	Polic 16 (Gjashtëmbëdhjetë)
Totali	Oficerë 1 (një) Policë 33 (tridhjetë e tre)

Teknika zjarrfikëse:

1. Autozjarrfikëse	3 (tre)
2. Autozjarrfikëse shpëtimi	1 (një)
3. Autozjarrfikëse e ndihmës së shpejtë	1 (një)
4. Motopompa portative 2 (dy)	
5. Radio ndërlidhje	5 (pesë)

V E N D I M
Nr. 290, datë 27.6.2002

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.319, DATË 23.6.2000 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR.433, DATË 3.9.1993 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR NDALIMIN E IMPORTIMIT TË GOMAVE TË PËRDORURA ""

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 1 të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991 "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe të privatizimit", me ndryshimet përkatëse, me propozimin e Ministrit të Industrisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.319, datë 23.6.2000 të bëhet ky ndryshim:

1. Në pikën 2, emërtimi "Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit" zëvendësohet me "Ministria Përgjegjëse për Industrinë".

2. Ngarkohet Ministria e Industrisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M
Nr. 295, datë 27.6.2002

PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, TË CILAT PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR KORÇË-KAPSHTICË NË TERRITORIN E QARKUT KORÇË

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 100 të Kushtetutës dhe në zbatim të neneve 5 pika 1, 20 dhe

21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", me propozimin e Ministrit të Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme të pronarëve, të cilët preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Korçë-Kapshticë në territorin e Qarkut të Korçës.

2.Shpronësimi të bëhet në favor të Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, të cilët shpronësohen, të kompensohen, në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, me sipërfaqe 19 989 m^2 tokë/arë, 4 996 m^2 truall, 496 m^2 ndërtesë, 5 pika karburanti me vlerë 14 366 913 lekë, 85 m^2 fidanë plepi dhe 125 dru frutorë.

4. Vlera e shpenzimeve procedurale të jetë në shumën prej 568 000 (pesëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë) lekësh.

5. Fondi prej 47 441 894 (dyzet e shtatë milionë e katërqind e dyzet e një mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e katër) lekësh, për kompensimin e pronarëve të shpronësuar, sipas pikave 3 dhe 4 të këtij vendimi, të përballohet nga buxheti i vitit 2002, zëri "Shpronësime", miratuar për Ministrinë e Transportit dhe Telekomunikacionit.

6. Shpronësimi të përfundojë brenda datës 30.6.2002.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M
Nr. 296, datë 27.6.2002

PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, TË CILAT PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR SHKODËR-VELIPOJË

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 100 të Kushtetutës dhe në zbatim të neneve 5 pika 1, 20 dhe 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", me propozimin e Ministrit të Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme të pronarëve, të cilët preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Shkodër-Velipojë.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, me sipërfaqe 1430 m^2 tokë/arë, 20 rrënjë hardhi, 2 rrënjë fiq, vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 1 315 425 (një milionë e treqind e pesëmbëdhjetë mijë e katërqind e njëzet e pesë) lekësh.

4. Vlera e shpenzimeve procedurale të jetë në shumën prej 132 000 (njëqind e tridhjetë e dy mijë) lekësh.

5. Fondi prej 1 447 425 (një milion e katërqind e dyzet e shtatë mijë e katërqind e njëzet e pesë) lekësh, për kompensimin e pronarëve të shpronësuar, sipas pikave 3 dhe 4 të këtij vendimi, të përballohet nga buxheti i vitit 2002, zëri "Shpronësime", miratuar për Ministrinë e Transportit dhe Telekomunikacionit.

6. Shpronësimi të përfundojë brenda datës 30.7.2002.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
QARKU: SHKODËR
KOMUNA: BËRDICË

Lista e pronarëve që shpronësohen për efekt të ndërtimit të segmentit rrugor Shkodër-Velipojë

Lloji i pasurisë së paluajtshme: tokë bujqësore nr.(1-6), dru frutorë

Nr	Pronarët			Nr. pikët.	Nr. i parcelës	Sip. Fakt. m^2	Çmimi Lek /m^2	Vlera në lekë	Fiq copë	Vlera Lekë	Rrush copë	Vlera lekë	Vlera e plotë në lekë
	Emër	Atësi	Mbiemër										
`1	Brahim	Arif	Koburja	13	101/1	101	900						90900
2	Prec	Ndoc	Cerjani	14-15	135/1	378	900						340200
3	Hysni	Metush	Meti	18-20	135/2	637	900						573300
4	Rrok	Mark	Bituku	20-22	531	162	900						145800
5	File	Lluke	Jaku	60-61	484/9	53	900						47700
6	Jac	Mark	Jaku	60-61	484/10	99	900		2	8283	20	20142	117525
	SHUMA												1315425

Shpenzime procedurale: 132 000 lekë.

V E N D I M
Nr. 301, datë 27.6.2002

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.277.DATË 18.7.1997 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PËRFITIMET NGA STATUSI I TË VERBËRIT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të ligjit nr.8089, datë 28.3.1996 "Për statusin e të verbërit", me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.277, datë 18.7.1997 të Këshillit të Ministrave të bëhet ky ndryshim:

1. Paragrafi i parë i pikës 4 ndryshohet si më poshtë vijon:

"Masa e pagesës për shkak të verbërisë është 6 000 lekë në muaj dhe indeksohet me rritjen e pagës minimale në shkallë vendi. Kjo pagesë përfitohet pavarësisht nga mosha dhe të ardhurat që përfitohen nga shteti.".

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi të përballohen nga buxheti i vitit

2002 për pagesën e paaftësisë, miratuar për Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 gusht 2002.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M
Nr. 302, datë 27.6.2002

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.31, DATË 20.1.2001 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PËRFITIMET NGA STATUSI I INVALIDIT PARAPLEGJIK DHE TETRAPLEGJIK"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 të ligjit nr.8626, datë 22.6.2000 "Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.31, datë 20.1.2001 të Këshillit të Ministrave të bëhet ky ndryshim:

1. Paragrafi i parë i pikës 4 ndryshohet si më poshtë vijon:

"Masa e pagesës për invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë është 6 000 lekë në muaj dhe indeksohet me rritjen e pagës minimale në shkallë vendi. Kjo pagesë përfitohet pavarësisht nga mosha dhe të ardhurat e tjera që invalidi paraplegjik dhe tetraplegjik përfiton nga shteti. Të njëjtën pagesë përfiton edhe kujdestari i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik, i caktuar në përputhje me pikën 1 të vendimit.".

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi të përballohen nga buxheti i vitit 2002 për pagesën e paaftësisë, miratuar për Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 gusht 2002.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M
Nr. 303, datë 27.6.2002

PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELIT TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË DREJTORISË SË PATENTAVE DHE MARKAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2 dhe 6 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Struktura dhe nivelet e pagave për pozicionet "specialist", "përgjegjës sektori" dhe "drejtor" në Drejtorinë e Patentave dhe Markave caktohen sipas lidhjes nr.1, që bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Paga e grupit (kolona 1) e lidhjes 1 - diplomë e shkollës së lartë - është 9 000 (nëntë mijë) lekë.

3. Shtesa për vjetërsi pune (kolona 2) jepet në masën 2% pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe llogaritet mbi pagën e grupit.

4. Shtesa për kualifikim (kolona 3) është 0.

5. Shtesa për pozicion është sipas kolonës 4 të lidhjes nr.1.

6. Pagat për punonjësit e tjerë të Drejtorisë së Patentave dhe Markave caktohen sipas lidhjeve II-5 dhe II/M të vendimit nr.726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave "Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore", me ndryshimet përkatëse.

7. Të gjitha dispozitat që bien në kundërshtim me këtë vendim shfuqizohen.

8. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi të përballohen nga buxheti i miratuar për vitin 2002 për Drejtorinë e Patentave dhe Markave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 16 korrik 2002.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

LIDHJA NR.1

Emërtimi	Paga mujore			
	Paga individuale			Shtesa e pozicionit
	Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP) lekë
	1	2	3	4

9 000 2% 0 90 000 Përgjegjës sektori 9 000 2% 0 40 000 Specialist 9 000 2% 0 20 000

V E N D I M
Nr. 304, datë 27.6.2002

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.311, DATË 11.7.1994 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PËRFITIMIN E PAAFTËSISË", ME NDRYSHIMET PËRKATËSE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7 të ligjit nr.7710, datë 18.5.1993 "Për ndihmën dhe përkujdesin shoqëror", me ndryshimet përkatëse, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.311, datë 11.7.1994 të Këshillit të Ministrave, ndryshuar me vendimin nr.457, datë 21.8.1995 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

1. Pika 3 ndryshohet si më poshtë vijon:

"3. Pagesa e përfitimit të paaftësisë është 6 000 lekë në muaj dhe indeksohet me rritjen e pagës minimale në shkallë vendi.".

2. Paragrafi i dytë i pikës 4 ndryshohet si më poshtë vijon:

"Masa e përfitimit të kujdestarisë është 5 000 lekë në muaj dhe indeksohet me rritjen e pagës minimale në shkallë vendi.".

3. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi të përballohen nga buxheti i vitit 2002 për pagesën e paaftësisë, miratuar për Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 gusht

2002.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M
Nr. 315, datë 4.7.2002

PËR NJË TRAJTIM TË VEÇANTË TË SHEFIT TË SHTABIT TË PËRGJITHSHËM TË FORCAVE TË ARMATOSURA PAS LIRIMIT NGA DETYRA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 4 të nenit 30 të ligjit nr.8671, datë 26.10.2000 "Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të pikës 4 të nenit 4 të ligjit nr.7508, datë 7.8.1991 "Për Policinë Ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të nenit 7 të ligjit nr.8847, datë 19.12.2001 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2002" dhe të shkronjës "a" të pikës 2 të nenit 112 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 "Kodi i procedurave administrative", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Marrja dhe dorëzimi i detyrës së Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë bëhet me ceremoni ushtarake, sipas rregullores së ceremonialit ushtarak.

2. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, pas largimit nga detyra, përfiton ruajtjen e afërt fizike, me shoqërues personal, deri në 1 (një) vit.

Ministria e Mbrojtjes merr përsipër caktimin e shoferit, të makinës dhe riparimin e saj, si dhe kuotën limit të furnizimit me karburant.

3. Kur paraqiten rrethana që rrezikojnë jetën e tij dhe të familjes, i sigurohet ruajtja e banesës, për aq kohë sa ekziston ky rrezik.

4. Efektivi që merret me ruajtjen dhe sigurimin e ish-shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë është pjesë e efektivit të regjimentit të Policisë Ushtarake.

5. Në rastet e lirimit nga detyra sipas shkronjave "a", "b" dhe "ç" të pikës 3 të nenit 30 të ligjit nr.8671, datë 26.10.2000 "Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", përfiton pagesë kalimtare (nga data e ndërprerjes së marrëdhënieve financiare) në masën 60 për qind të pagës referuese për funksion (gradë), për aq kohë sa ka vjetërsi në detyrë, si Shef Shtabi, por jo më shumë se 3(tre) vjet.

6. Në rast sëmundjeje, brenda vitit të parë të lirimit nga detyra, trajtimi financiar për kurim, në ose jashtë vendit, përballohet në masën 100 për qind nga fondet e Ministrisë së Mbrojtjes.

7. Të drejtat e përcaktuara në këtë vendim përfitohen kur kohëzgjatja e qëndrimit në detyrë është jo më pak se një vit.

8. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi planifikohen dhe përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M
Nr. 316, datë 4.7.2002

PËR MËNYRËN E TRAJTIMIT ME STREHIM TË JETIMËVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2 dhe 17 të ligjit nr.8153, datë 31.10.1996 "Për statusin e jetimëve", me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, nëpërmjet Entit Kombëtar të Banesave, të planifikojë fondet për jetimët që gëzojnë statusin e të pastrehut, sipas kërkesës së organeve të qeverisjes vendore, për trajtimin me përparësi me strehim të tyre.

2. Çdo person që gëzon statusin e jetimit ka të drejtë të bëjë kërkesë për strehim pranë organeve të qeverisjes vendore që nga data e mbushjes së moshës 18 vjeç.

3. Personi i pastrehë, me statusin e jetimit, të trajtohet me banesë nga Enti Kombëtar i Banesave, sipas kritereve të ligjit nr. 8030, datë 15.11.1995 "Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha".

4. Shpenzimet operacionale të Entit Kombëtar të Banesave të përballohen nga Buxheti i Shtetit, për rastet kur:
individi ose kryefamiljari me statusin e jetimit është i moshës nga 18 deri në 25 vjeç;
-kryefamiljari me statusin e jetimit është grua e ve ose e divorcuar dhe ka fëmijë në ngarkim.

5. Kërkesat për strehim administrohen nga organet e qeverisjes vendore, në bashkëpunim me Shoqatën e Jetimëve të Shqipërisë. Organet e qeverisjes vendore caktojnë radhën, përparësitë e trajtimit dhe strukturat që i takojnë çdo familjeje. Këto organe, nëpërmjet këshillave bashkiakë ose komunalë, hartojnë listat e të pastrehëve për personat që gëzojnë statusin e jetimit, në çdo kohë, si dhe dokumentacionin e plotë dhe i dërgojnë pranë Entit Kombëtar të Banesave, për planifikim fondesh, brenda datës 1 gusht të çdo viti. Dokumentacioni përmban të gjitha dokumentet që përcaktohen në aktet, ligjore e nënligjore, për strehimin.

6. Qendër banimi për personat që kanë përfituar nga statusi i jetimit të jetë qendra ku ata kanë përfituar statusin e të pastrehut.

7. Sipas kritereve të këtij vendimi, trajtohen personat që gëzojnë statusin e jetimit, të cilët kërkojnë banesë për herë të parë. Në këtë kategori hyjnë:

-personat e sapo dalë nga jetimoret dhe të pasistemuar në konvikte ose me strehim të përkohshëm;

-personat ose kryefamiljarët, që banojnë në konvikte ose mjedise që nuk janë fond banese;

-kryefamiljari grua, me statusin e jetimit, dhe që nuk ka banesë në pronësi.

8. Për hartimin e listave të të pastrehëve me statusin e jetimit nuk zbatohen afatet kohore të përcaktuara në pikën 1 të vendimit nr.250, datë 16.4.1996 të Këshillit të Ministrave "Për procedurat dhe prioritetet në zbatim të ligjit nr.8030, datë 15.11.1995 "Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha"", ndryshuar me vendimin nr.513, datë 24.11.1997 të Këshillit të Ministrave.

9. Ngarkohen Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale dhe Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M
Nr. 317, datë 4.7.2002

PËR LIKUIDIMIN E SHOQËRISË ANONIME "AGJENCIA PËR ZHVILLIM EKONOMIK" (AZHE)

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 264 të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare", me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Likudimin e shoqërisë anonime "Agjencia për Zhvillim Ekonomik", Tiranë.

2. Vendimi nr.442, datë 16.7.1998 i Këshillit të Ministrave "Për krijimin e shoqërisë "Agjencia për Zhvillim Ekonomik" sh.a." shfuqizohet.

3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendimi hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M
Nr. 318, datë 4.7.2002

PËR VENDOSJEN E OFICERËVE TË KONTAKTIT TË MINISTRISË SË RENDIT PUBLIK PRANË MINISTRIVE HOMOLOGE TË GREQISË, ITALISË, TURQISË DHE UNMIK-UT KOSOVË, TË ATASHUAR NË PËRFAQËSITË DIPLOMATIKE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1 të nenit 61 të ligjit nr.8553, datë 25.11.1999 "Për Policinë e Shtetit" dhe të ligjit nr.8847, datë 19.12.2001 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2002", me propozimin e Ministrit të Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Përfaqësimin e Ministrisë së Rendit Publik, me oficerët e vet të kontaktit, pranë ministrive homologe në Greqi, Itali, Turqi dhe UNMIK-ut në Kosovë, të atashuar në përfaqësitë diplomatike të Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të marrëveshjeve, protokolleve apo procesverbaleve respektive, në luftë të përbashkët kundër trafikut ndërkombëtar të lëndëve narkotike, terrorizmit, krimit të organizuar, trafikut të armëve, emigracionit të paligjshëm dhe pastrimit të parave të pista.

Përfaqësimi të realizohet nga një oficer kontakti, për çdo vend respektiv.

2. Oficerët e kontaktit emërohen nga Ministri i Rendit Publik, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, në përputhje me pikën 4 të nenit 19 të ligjit nr.8553, datë 25.11.1999 "Për Policinë e Shtetit" për një periudhë jo më pak se dy vjet. Emërimi i tyre u njoftohet zyrtarisht ministrive homologe ose organeve zyrtare përgjegjëse.

3. Oficerët e kontaktit gjatë veprimtarive të tyre në shtetet respektive mbeten organikë e institucionit që i emëron dhe, në përfundim të misionit, gëzojnë të drejtën e rikthimit në institucionin ku kanë punuar para emërimit në këtë detyrë.

4. Statusi, imuniteti dhe privilegjet që gëzojnë oficerët e kontaktit, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre në vendet respektive, rregullohen sipas marrëveshjeve bazë (protokollet ose procesverbalet) të nënshkruara ndërmjet Ministrisë së Rendit Publik të Republikës së Shqipërisë dhe ministrive homologe respektive, si dhe në përputhje me legjislacionet përkatëse.

5. Oficerët e kontaktit, në vend të pagës, marrin alokacione në valutë. Alokacionet janë në përpjestim me suksesin dhe rreziqet që mbart lufta kundër krimit të organizuar dhe trafiqeve të tjera. Për masën e alokacionit të merret për bazë tabela e pagave, sipas vendimit nr.473, datë 29.9.1993 të Këshillit të Ministrave "Për të drejtat e punonjësve të përfaqësive diplomatike të Republikës së Shqipërisë në shtetet e huaja dhe për shpenzimet e udhëtimit dhe të dietës për personat që dalin jashtë shtetit", me ndryshimet përkatëse. Masa e alokacionit përbëhet nga alokacioni individual dhe shtesat për profesionin. Përveç alokacionit, oficeri i kontaktit përfiton dhe prime motivuese, vlera e të cilave bazohet në meritat individuale dhe nivelin e realizimit të detyrave.

Për këtë qëllim, oficerët e kontaktit barazvlerësohen në gradë me këshilltarin e përfaqësisë diplomatike.

6. Sistemimi me zyrë i oficerëve të kontaktit të bëhet në mjediset e përfaqësive tona diplomatike në vendet respektive. Bashkëshortët dhe fëmijët në ngarkim, gjatë qëndrimit në vendet përkatëse, pajisen me pasaporta diplomatike, si dhe gëzojnë të drejtat dhe detyrimet sipas neneve 20

pika "c", 21 dhe 24 të ligjit nr.8370, datë 9.7.1998 "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë". Përfaqësitë diplomatike shqiptare t'u krijojnë të gjitha kushtet e nevojshme për kryerjen e veprimtarisë.

7. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi të përballohen nga buxheti i vitit 2002, miratuar për Ministrinë e Rendit Publik. Kjo ministri të parashikojë fondet përkatëse në buxhetin e vet, për çdo vit për shpenzimet e oficerëve të kontaktit.

8. Ngarkohen Ministria e Rendit Publik dhe Ministria e Punëve të Jashtme për hartimin e udhëzimit të përbashkët dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M
Nr. 323, datë 4.7.2002

PËR KALIMIN E KORPUSIT TREKATËSH TË "ALIMPEKS" SH.A.-SË SHKOZET, DURRËS, NË PRONËSI TË MINISTRISË SË PUNËS DHE ÇËSHTJEVE SOCIALE

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10, 13 dhe 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit" dhe të nenit 2 të ligjit 7889, datë 14.12.1994 "Për statusin e invalidit", me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N DO S I:

1. Kalimin e magazinave të korpusit trekatësh, me pamje nga deti, me sipërfaqe ndërtimi 1182.9 m2 për çdo kat, që ndodhet në administrimin operativ të "Alimpeks", sh.a.-së, Shkozet, Durrës, në pronësi të Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale për nevoja të invalidëve të punës, dega Tiranë.

2. Ngarkohet Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale për kalimin e objektit, të përmendur në pikën 1, në huapërdorim të Shoqatës së Invalidëve të Punës, dega Tiranë.

3. Ngarkohen Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale dhe "Alimpeks", sh.a.-ja, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M
Nr. 324, datë 4.7.2002

PËR PAGESËN E KONTRIBUTEVE TË ORGANIZATËS NDËRKOMBËTAREB TË MIGRACIONIT (IOM)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7 të ligjit nr.8847, datë 19.12.2001 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2002", ndryshuar me ligjin nr.8903, datë 23.5.2002, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Pagesën, nga Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale, të kontributeve të prapambetura, në shumën prej 9 000 000 (nëntë milionë) lekësh, që i ka vendi ynë Organizatës Ndërkombëtare të Migracionit (IOM), sipas Marrëveshjes të datës 2 tetor 1992, ndërmjet Qeverisë Shqiptare dhe kësaj organizate.

2. Ky fond të përballohet nga buxheti i vitit 2002, miratuar për Ministrinë e Punës dhe

Çështjeve Sociale.

3. Ngarkohen Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale dhe Ministria e Punëve të Jashme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

Fletorja Zyrtare gjendet:

- Në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Rr.Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

U dorëzua për shtyp më 12. 7. 2002
Doli nga shtypi më 13. 7. 2002

Tirazhi: 4250 copë	Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2002

Çmimi: 150 lekë